

REGJISTR I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifat ⁷
1	12.01.2023	Kerkese per informacion dhe kopje te dokumentave zyrtare	08.02.2023	Ne përgjigje te shkreses se Komisionerit per te drejten per Informim dhe Mbrojtjen e te dhenave personale, nr 234/2 prot, date 31.01.2023 " Mbi ankimin ndaj refuzimit per dhenie informacioni dhe kopje te dokumentave zyrtare" ju bejme me dije se nuk jemi vene ne dijeni me pare, pasi adresa e koordinatorit per te drejten per Informim prane Universitetit " Aleksander Moisiu " Durres, eshte : vilmatapelena@uam.d.edu.al dhe jo.info@uam.d.edu.al .	Përgjigje e Pjesshme	S'ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosho monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				<p>Ne keto kushte , me anen e shkreses se sipercituar, te protokolluar prane nesh me date 02.02.2023. jemi vene ne dijeni te problematikes perkatese dhe ne vijim do te procedojme me venien ne dispozicion te informacionit te kerkuar, sa me shpejt te jete e mundur.</p> <p>Njekohesisht , po ju veme ne dispozicion edhe informacionin e kerkuar ne shkrese, si me poshte vijon :</p> <p>Ju informojmë që nuk ka VKM ose Urdhër specifik për njohjen e diplomave Bachelor të lëshuara nga Institucione të Arsimit të Lartë -jo publike për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.</p> <p>Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzim Nr.10, datë 15.05.2019 "Për</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë"</p> <p>(Ndryshuar me udhëzimin nr. 17, datë 30.7.2019; nr. 19, datë 10.9.2019, nr. 15, datë 26.5.2020, nr. 17, datë 23.6.2020, nr. 25, datë 1.12.2020; nr. 11, datë 2.6.2021)</p> <p>Pranimi i kandidatëve në programet e ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional nuk kufizohet nga statusi i mbyllur ose aktiv i Institucionit që ka lëshuar diplomën por bazuar në Kreun IV/4 neni 8 pika a) dhe b) përcaktohet që kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që :</p> <p>a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>Shqipërisë, për një program të licencuar në momentin e regjistrimit të studentit mbartë të diplomës dhe të akredituar në momentin e lëshimit të diplomës.</p> <p>Për këtë arsye ju rikonfirmoj që nuk ka VKM ose Urdhër që përcakton nëse UAMD njih ose jo diplomat e lëshuara nga Institucione të Arsimit të Lartë. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës verifikon në çdo rast vlefshmërinë e diplomës së kandidatëve për student në ciklin e dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional konform ligjit të Arsimit të Lartë pa u ndikuar nga statusi i Institucionit që e ka lëshuar.</p> <p>Njëkohesisht, bashkëlidhur këtij emaili do të gjeni edhe listën me numrin e studentëve në nivel master të cilët janë mbajtës të një diplome bachelor nga ish-Universitetet Private të mbyllura dhe që janë diplomuar nga</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës në Mastera Profesional ose Shkencor gjatë 10 viteve të fundit.		
--	--	--	---	--	--

Koordinatorë për të Drejtën për Informim
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
Vilma Tepelena



REGJISTRIT I KËRKESAVE DHE PËRGGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarif ⁷
1	19.05.2023	Kërkesë për informacion nëse Universiteti disponon Rregullore mbi procedurat e brendshme lidhur me marrjen dhe administriminin e ankesave apo raportimeve për raste korruptive nga sinjalizuesit.	29.05.2023	Në përgjigje të shkresës suaj "Kërkesë për Informacion" ju bëjmë me dije se me Vendimin e Senatit Akademik, nr 126 datë 09.11.2017 është miratuar Rregullorja e Brëndshme e Universitetit "Aleksandër Moisiu". Durrës "Për Hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe mbrojtjen e konfidencialitetit", të cilën po jua vëmë në dispozicion bashkëlidhur këtij emaili. Konkretisht në nenin 15 të Rregullores, është parashikuar mbrojtja e të dhënave personale të individëve të përfshirë në	Përgjigje e plotë	S'ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dergimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				<p>hetimin administrativ të cilat përpunohen në zbatim të Ligjit nr 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalzuesve".</p> <p>Ju bëjmë me dije se gjatë viteve 2020, 2021, 2022, Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalzuesve në Universitetin "Aleksander Moisiu", Durrës, nuk ka marrë asnjë sinjalizim në lidhje me raste korruptive. Për çdo informacion në vijim, në faqen e WEB-it të Universitetit "Aleksander Moisiu", Durrës janë të publikuara detajet e kontaktit mbi personelin e autorizuar që vepron ndaj sinjalzimeve.</p>		
2	06.07.2023	<p>Kërkesë për informacion për programet profesionale të studimit që ofron Universiteti, kerkese per</p>	07.07.2023	<p>Ju bëjmë me dije se aktualisht e kemi të pamundur vënien në dispozicion të informacionit</p>	<p>Kërkesë për shtyrtjen e dhënies së përgjigjes</p>	S'ka

		<p>informacion në lidhje me njohtjen e këtyre diplomave, kërkesë për informacion nëse janë punësuar këta student dhe cilat janë punet që janë punësuar</p>		<p>që kërkoni duke qënë se zyrat që duhet t'ju vënë në dispozicion informacionin janë të angazhuar maksimalisht në përgatitjen e diplomave të studentëve dhe njëkohësisht të angazhuar në një proces tjetër shumë të rëndësishëm siç është ai i akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Në këto kushte, ju lutem kërkojmë mirëkuptimin tuaj për shtyrjen e dhënies së këtij informacioni, pas dates 05 shtator 2023.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

Koordinatorë për të Drejtën për Informim
Universiteti "Aleksanër Moisiu" Durrës

Vilma Tepelena


REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarif ⁷
1	06.07.2023	Kërkesë për informacion për programet profesionale te studimit që ofron Universiteti , kerkese per informacion në lidhje me njohjen e këtyre diplomave, kërkesë për informacion nëse janë punësuar këta student dhe cilat janë punet që janë punësuar	18.07.2023	Fakulteti i Studimeve Profesionale (ish Shkolla e Lartë Profesionale) si një nga 5 fakultetet e Universitetit "Aleksander Moisiu" Durrës, që në hapjen e tij në vitin 2006, ka ofruar programe studimi 2-vjeçare me karakter profesional. Në vitin akademik 2022-2023 ky fakultet ofron 13 trembëdhjetë programe 2-vjeçare: Ndihmës Dentist, Asistent Administrativ, AsistentLigjor, Informatikë Praktike,Specialist Rrijetesh Kompjuterike,Hidroteknikë Ujësjetelës,Kanalizime, Mekanikë Detare, Mekanik i Impianteve Industriale e Bujqësore ,Menaxhim Ndërtimi, Menaxhim Transporti	Përgjigje e plotë	S'ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosho monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				<p>Detar/Tokësor, Specialist i Sistemeve të Kondicionimit, Teknik Elektrik, Teknologji Automoblash.</p> <p>2. Studentët që përfundojnë këto programe studimi 2-vjeçare me karakter profesional fitojnë 120 kredite ECTS që i përkasin nivelit të pestë të Kormizës Shqiptare të Kualifikimit dhe në bazë të ligjit 80 / 2015 për arsimin e lartë pajisen me Diplomë Profesionale.</p> <p>3. Në pesë vitet e fundit numri i studentëve të diplomuar sipas programeve jepet në tabelë.</p> <p>Tre programet e studimit Mekanikë Detare, Mekanik i Impianteve Industriale e Bujqësore dhe Specialist i Sistemeve të Kondicionimit janë hapur në vitin akademik 2020-2021 dhe të diplomuarit e brezit të parë i takojnë vitit 2021-2022.</p> <p>4. Studentët kanë interesa për programe të ndryshme, në bazë të kërkesave të tregut dhe kërkesave të punëmarësve privatë për t'i punësuar pas studimeve, profesioneve që dëshirojnë të ushtrojnë, mundësiive për punësim në tregjet e vendit nga ato vijnë, shteteve të tjera ku ato duan të emigrojnë e ju njihen këto studime që kanë kryer.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>5. Studentët pas përfundimit të një programi 2-vjeçar me karakter profesional fitojnë një Diplomë Profesionale, në përputhje të plotë me ligjin 80 / 2015 për arsimin e lartë dhe si e tillë kjo Diplomë Profesionale njihet nga shteti shqiptar. Institucionet publike të shtetit shqiptar, por edhe shoqëritë aksionere, si edhe çdo biznes tjetër privat, sipas kërkesave që kanë për specialistë të fushave të ndryshme: si asistent ligjor e administrativ pranë gjykatave e prokurorive, specialistë hidroteknikë, elektrikë, transporti pranë ndërmarrjeve të Ujësullës Kanalizimeve (Sh. A.), operatorëve të OSHE (Sh. A.), sektorëve të transportit pranë bashkive, eji, mund të punësojnë këto studentë që disponojnë një Diplomë Profesionale. Por kërkohej që këto Diploma Profesionale të përfshihen në listën e profesioneve të rregulluara të DAP.</p>		
				<p>6. Entet dhe subjektet private janë më së shumti të interesuar për të punësuar studentët e diplomuar në një profil profesional, sidomos specialist elektrik, mekanik automjesh e makinash bujqësore, specialist kondicionimi, specialist hidroteknik.</p>		
				<p>7. Përpara hyrjes në fuqi të ligjit 80 / 2015 për arsimin e lartë kishite rreth 5-7</p>		

				<p>studentë me rezultatet më të larta që vazhdojnë një program Bachelor. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit 80 / 2015 për arsimin e lartë, Diplomat Profesionale që i përkasin nivelit të pestë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit dhe Diplomat Bachelor që i përkasin nivelit të gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, u takojnë cikleve të ndryshme të studimit dhe nuk lejohet transferimi i studimeve. Kështu studenti duhet të aplikojë njësoj si një maturant, por duke qenë se vazhdon një program të dytë studimi tarifa e shkollimit është e lartë, pra jo favorizuese edhe nga ana financiare.</p> <p>Bashkëlidhur këtij emaili do të gjeni numrin e studenteve të diplomuar për pesë vitet e fundit</p>		
2	31.08.2023	<p>Kerkesë për : Kopje të Kontratave , detajeve shogruese te tyre dhe anekseve per blerjet dhe shpenzimet e meposhme gjate perudhes 1 shtator 2022 - 30 korrik 2023. - Kontrate "Blerje pajisje per laboratorin e Mami- Infermier" Subjekti : Isometrik shpk Vlera pa TVSH : 4.200.000 All</p>	14.09.2023	<p>Ne pergjigje te kerkeses per sa i takon kontratave te lidhura me pale te trete per procedurat e prokurimit publik gjate periudhes I shtator 2022 - 30 korrik 2023 te Universitetit Aleksander Moisiu, Durres ju informojme se:</p> <p>Ky informacion është i aksesueshem në faqen zyrtare www.app.gov.al, ku</p>	Përgjigje e plotë	S'ka

		<p>Kontrate "Digitalizimi i Arshives se Universitetit Aleksander Moisiu Durrës"</p> <p>Subjekti : Atom shpk</p> <p>Vlera me TVSH : 32.288.400 All</p> <p>Kontrate "Blerje pajisje elektronike ne kuader te projektit te Nderkombetarizimit per programin e studimit "Diplome e dyfishite ne ciklin e tete te studimeve Doktorature ne Shkencat Edukimi" Vlera me TVSH : 15.730.000All</p>		<p>përzgjidhet rubrika e Njoftimit të lidhjes së kontratës dhe vendoset në fushën Kërkim i avancuar përçaktimi Autoriteti Kontraktues " Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës". Pas përzgjedhjes së kësaj fushe do tju shfaqen të gjitha kontratat e lidhura nga ky Autoritet Kontraktues.</p>		
3	07.09.2023	<p>Duke gene se Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës numëron rreth 15 mijë studente në ciklet e ndryshme të studimit , kërkojnë informacion se me përfundimin e e punimeve për ndërtimin e Universitetit "Aleksander Moisiu" Durrës, pse nuk është menduar për konviklet , një problematike kjo e cila ka sjelle penalizimin e studentëve qe vijne nga rrethet</p> <p>Në këto kushte, kërkohet informacion në lidhje me ecurinë e planifikimit të ndërtimit të konvikteve për studentët e Universitetit "Aleksander Moisiu" Durrës.</p>	21.09.2023	<p>Në kërkesën tuaj është kërkuar informacion rreth ecursisë së planifikimit dhe të ndërtimit të konvikteve për studentët e këtij Universiteti. Nisur nga sa kërkohet ju bëjmë me dije se aktualisht në vendin tonë funksionojnë 8 shoqëri për akomodimin e studentëve (shoqëritë e trajtimit të studentëve) 3 prej të cilave janë në Tiranë dhe 5 të tjera në Vlorë, Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë dhe Korçë dhe nuk ekziston një e tillë në Durrës.</p> <p>Shoqëritë e trajtimit të studentëve janë të organizuara në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare". Këto shoqëri janë me kapital 100% shtetëror, me pronar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me përjashtim të rezidencave studentore 1,2,3 të Universitetit të Tiranës të cilat janë transferuar në masën 100% të aksioneve tek Bashkia Tiranë, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 04.05.2016 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Shoqëritë e tjera, në Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë dhe Elbasan janë në administrim të Ministrisë të Financave dhe</p>	Përgjigje e plotë	S'ka

				<p>Ekonomikë dhe marrin mbështetje financiare nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Të gjitha shoqëritë marrin fonde grant për mbështetje financiare nga MASR për të mbuluar dhe 50% të shpenzimeve të tyre, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat nga tarifat e studentëve. Administrimi i këtyre shoqërive kryhet përmes Këshillave Mbikqyrës, ku përfaqësues me shumicë janë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe një përfaqësues nga MASR.</p> <p>Fondet për shpenzimet korrente në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve transferohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë bazuar në:</p> <p>Vendimin nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të IAL-ëve"</p> <p>Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003 "Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave";</p> <p>Udhëzimit nr. 394, datë 21.08.2014 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregëtare me kapital tërësisht shtetëror"</p> <p>Qeveria Shqiptare në kuadër të Paktit për Universitetin në vitin 2018 ka argumentuar se baza ligjore për ndërmarrjet e trajtimit të studentëve ka nevojë të rishikohet pasi udhëzimet janë të një periudhe të hershme dhe nuk pasqyrojnë dhe reflektojnë situatën aktuale që lidhet me ndryshimet që kanë pasuar çmimet e mallrave dhe shërbimeve bazë që i nevojiten këtyre shoqërive. Mbështetur në bazën ligjore të sipërcituar këto shoqëri funksionojnë si shoqëri aksionere sh.a me kapital 100% shtetëror. Në këtë kontekst vetëm Ministri i</p>
--	--	--	--	--

				<p>Në lidhje me kërkesën tuaj ju sqarojmë se:</p> <p>1. Afati i ruajtjes së dokumentacioneve si provime, detyra kurse, vërtetime praktike, etj. sipas shkrësës së Komisionit të ekspertizës e miratuar nga Dekani me nr. 6/1 prot., datë 17.01.2023 është 1 një vit.</p> <p>Ju jeni diplomuar me datë 29.09.2022 dhe praktika e fundit është dorëzuar me datë 11.04.2022.</p> <p>2. Si citohet edhe në kërkesën tuaj, ju kërkonti kopje të skanuar të të gjitha praktikave mësimore të firmosura dhe të vulosura nga ana e biznesit pranë të cilit është kryer edhe praktika.</p> <p>pra të dokumentacioneve që nuk i ka hartuar Universiteti dhe ne keto kushte duhet të drejtoheni pranë bizneseve që i kanë lëshuar këto dokumenta.</p>	Pergjigje e plotë	S'ka
4	27.09.2023	<p>Kërkesë për kopje të skanuara të të gjitha praktikave mësimore të dorëzuara nga ana e subjektit Kerkues te Studimeve Profesionale, Departamenti DESTIP, Gjithsej jane dorëzuar 5 praktika.</p>	09.10.2023			

Koordinatorë për të Drejtën për Informim
 Universiteti "Aleksanër Moisiu" Durrës
 Vilma Tepelena

